



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare



Viti: 2018 – Numri: 34

Tiranë – E hënë, 3 shtator 2018

PËRMBAJTJA

Njoftim i Institucionit
të Komisionerëve Publikë
nr. 352/1, datë 31.8.2018

Shpallje për vende të lira pune.....

Faqe

3



NJOFTIM
Nr. 352/1, datë 31.8.2018
SHPLLJE PËR VENDE TË
LIRA PUNE

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit të Komisionerëve Publikë”, shpall vendin vakant për pozicionin:

Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun (paga II-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master i shkencave” për Drejtësi;
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- c) Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në nivel drejtues e menaxherial.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 6 deri 13 shtator 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 4, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora: 09:00–16:00.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 4, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 13.9.2018 dhe të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf: 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti).

- Dokumentet (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetëdeklarim, certifikata, trajnime etj.) fotokopje ose të noterizuara. Diplomat që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria, dëshmi e gjendjes gjyqësore).

- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

- Një rekomandim nga punëdhënësi.

- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës i parashetrojnë Komitetit *ad-hoc* dokumentet e njësuar ose ato origjinale.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.